




Dr. Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2718 / Prot. 7

Vlorë më, 21 .11 .2024

VENDIM

Nr. 77, datë 20.11.2024

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE, "DOKTORATË NË
MATEMATIKË" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit, 70, 77, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", e ndryshuar, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Përgjegjesit të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik, me shkresë 2652, prot, datë, 20.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2024,

VENDOSI


1. Të miratojë propozimin e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë në Matematikë", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

A. Saliaj
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROMOVIMIT AKADEMIK

Nr. 2652 Prot.

Vlorë më, 19.11.2024

Lënda: Përcjellje për miratimin në Senatin Akademik propozimin e Fakultetit Shkencave Teknike dhe Natyrore për riorganizimin e programit të Ciklit të Tretë të Studimeve, Doktoratë në “Matematikë”

PROF. DR. AURELA SALIAJ
KRYETARE E SENATIT AKADEMIK
UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” VLORË

KËTU

Bazuar në Udhëzimin e MAS me nr.1, datë 14.01.20220 “Mbi dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë” (ndryshuar, me udhëzimin nr.22, datë 03.09.2020, nr. 23, datë 28.9.2020; nr 7, datë 31.03.2021; nr.5, datë 08.03.2022), si dhe në VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë” (ndryshuar me VKM nr 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr.185, datë 25.03.2021) bashkangjitur po Ju përcjell për miratim në Senatin Akademik, propozimin e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore për aplikimin/riorganizimin e programit Doktoratë në “Matematikë”.

Bashkëlidhur kësaj shkrese:

1. Relacioni për riorganizimin e programit të Ciklit të Tretë të Studimeve , Doktoratë në “Matematikë”
2. Shkresa e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore me nr. 2650 prot, datë 19.11.2024.

PËRGJEGJËSE SEKTORI
LEDJA ÇELAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROMOVIMIT AKADEMIK

**RELACION MBI RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË
TË STUDIMEVE DOKTORATË NË "MATEMATIKË"**

Bazuar në Udhëzimin e MAS me nr.1, datë 14.01.20220 "Mbi dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" (ndryshuar, me udhëzimin nr.22, datë 03.09.2020, nr. 23, datë 28.9.2020; nr 7, datë 31.03.2021; nr.5, datë 08.03.2022) nga ana e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore është paraqitur propozimi për riorganizimin e programit të Ciklit të Tretë të Studimeve , Doktoratë në "Matematikë"

Riorganizimi i programit të studimit të Ciklit të Tretë: Doktoratë në "Matematikë" do të ndrryshoj në dy drejtime:


Matematikë e aplikuar dhe Matematikë Teorike. Programi i studimit është riorganizuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit .

Qëllimi:

Shkolla e Doktoratës do të vendos në dispozicion të studentëve gamë të gjerë kursesh nga fushat e ndryshme të matematikës e që kanë si subjekt zhvillimet më të fundit të këtyre fushave me qëllim që studentët jo vetëm të specializohen sa më mirë në drejtimet që do të zgjedhin por, nëse dëshirojnë, të krijojnë një panoramë njohëse sa më të gjerë të matematikës së sotme.

Objektivat :

- Të përgatisë ekspert të analizave dhe parashikimeve financiare, për vlerësimin sasior të rrezikut që lidhet me investimet produktive dhe/ose financiare dhe i përcaktimit të politikave të alokimit të burimeve.
- Të përgatisë hulumtues në kompanitë që zhvillojnë modelimin e aplikuar.
- Të përgatisë ekspert në logjistikën e shpërndarjes për optimizimin e aktiviteteve si shërbimi ndaj klientit, parashikimi i kërkesës, menaxhimi i komunikimit, menaxhimi i aksioneve, trajtimi i materialeve, caktimi, vendndodhja e fabrikave dhe e depove, transporti (përfshirë aeroportet) shpërndarja dhe magazinimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROMOVIMIT AKADEMIK

- Të përgatisë ekspert në përpunimin dhe menaxhimin e sasive të mëdha të të dhënave duke përdorur mjetet matematikore të Shkencës së të Dhënave në kompani, organe publike, ose qendrat kërkimore që i përdorin ato.

Lloji i programit: Doktoratë

Kohëzgjatja normale: 3 Vite

Kreditet: 180 kredite

Njësia ofruese: Departamenti i Matematikës dhe Fizikës

Numri total i personelit të angazhuar : 12

Departamenti i Matematikës dhe Fizikës: 5,

Personel akademik i jashtëm ose i ftuar: 7

Kapacitetet pritëse: 2-5 studentë.